



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm KSHPK) në seancën e 60-të, të mbajtur më 28.01.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 09-3680/1 nga data 04.10.2021, kundër personit ///, drejtor i ///t, **REFUZOHET.**

Përndryshe, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme për shkak të mungesës së pretendimeve të mjaftueshme dhe të qarta në denoncim dhe KSHPK-ja nuk ka mundësi të ofrojë informata shtesë.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 09-3680/1 datë 04.10.2021 është ngritur në bazë të kërkesës së dorëzuar me e-mail në adresën elektronike të kontaktit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, kundër personit /// – ///, me pretendime se në këtë institucion ka punësuar një person të afërt (gruan e vëllait).

Në denoncim nuk jepen të dhëna për personin që dyshohet se ka qenë i punësuar, të cilat janë të nevojshme që Komisioni Shtetëror të mund të veprojë.

Për konstatimin e gjendjes faktike, Komisioni Shtetëror i është drejtuar e-mailit të parashtruesit të kërkesës për sqarimin e pretendimeve në denoncim me emrin dhe mbiemrin e personit që denoncon se ka qenë i punësuar në ///.

Pas një kërkesë të tillë, parashtruesi nuk ka dorëzuar një njoftim që do të saktësonte më tej pretendimet, në bazë të të cilave Komisioni Shtetëror do të mund të veprojë në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe të konstatojë nëse në këtë rast bëhet fjalë për konflikt interesi.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprime kompetente, prandaj u vendos si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Kryetar,
Biljana Ivanovska

Sipas përfundimit të KSHPK-së,
Punoi: E.N, bashkëpunëtor
E kontrolluar nga: K.Z., Udhëheqëse
Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së